



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1677/8 prot.

Tiranë, më 26 .07.2024

**VENDIM**

**Nr. 12 , datë 26 . 07 .2024**

**PËR KONTROLLUESIN “QENDRA E ZHVILLIMIT TË FËMIJËVE ME**  
**AFTËSI NDRYSHE”, BASHKIA LUSHNJË**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Qendrës së Zhvillimit të fëmijëve me aftësi ndryshe*”, *Bashkia Lushnjë* (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 106, datë 26.06.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Qendra është pjesë e strukturës organizative të Bashkisë Lushnjë, bazuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 355, datë 07.12.2023 “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Lushnjë për vitin 2024*”.

Si pjesë integrale e njësisë së vetëqeverisjes vendore, Qendra e ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit Qendra mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “nëpunës”, “vizitorë”, “fëmijë”, “prindër”, etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

2. Kontrolluesi disponon rregullore të brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Zhvillimit Lushnje” për Qendrën, megjithatë, nga shqyrtimi i dispozitave të saj, rezulton se nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së dokumentacionit që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron, i cili përmban edhe të dhëna personale. Gjithashtu, të dhënat e mbledhura nga Qendra ku përfshihen edhe të dhëna sensitive, ruhen pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezultoi se, Kontrolluesi ka përmbushur detyrimin për “Njoftim”. Megjithatë, konstatohet se Formulari ka nevojë të përditësohet në rubrikat si më poshtë:
  - i. Deklarimin në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit “Të dhënat e subjektit Kontrollues”;
  - ii. Deklarimin në rubrikën 1.2, të formularit të njoftimit “Personi i kontaktit”;
  - iii. Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”;
  - iv. Deklarimin në rubrikën 4.1, të formularit të njoftimit “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”;
  - v. Deklarimin në rubrikën 5.1, të formularit të njoftimit “Të dhënat sensitive që përpunohen”;
  - vi. Deklarimin në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “Qëllimi i përpunimit”;

Konstatimet e mësipërme bien në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre që i jep Ligji.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës ku ushtron veprimtarinë Qendra, për qëllim të sigurisë së personelit, fëmijëve dhe pronës.

Kontrolluesi, disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV por tabela nuk është sipas modelit standard, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri.

Me “*CCTV- Closed-Circuit Television*” nënkuptohet Televizioni me Qark të Mbyllur ose video-survejim, pra përdorimi i kamerave televizive me qark të mbyllur për të transmetuar një sinjal në një vend të caktuar, në një grup të kufizuar monitorësh.

Gjatë verifikimit në vend të sistemit të video-survejimit CCTV rezulton se, ky sistem të ofron mundësinë e skanimit të një barcode për ta shkarkuar si aplikacion në aparatët celularë dhe pasi e instalon aplikacionin nëpërmjet një barcode “*Device SN*”, bëhet log-in dhe mund të aksesohen të gjithë kamerat që disponon Kontrolluesi, si për pjesën e rrjetit intranet, por dhe në rastin e përdorimit të pajisjeve mobile nëpërmjet internetit, pasi ky sistem është i lidhur në rrjet. Pra, aplikacioni që përdor sistemi i video-survejimit CCTV u jep mundësinë personave që kanë akses në këtë sistem, të përdorin lehtësisht kamerat në pajisjet *smartphone* dhe të aksesojnë në “*Storage*” të këtij sistemi ku ruhen imazhet/videot.

Gjithashtu, lidhur me këtë proces përpunues, rezulton se Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejimit CCTV të Qendrës.

Për sa më sipër, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur aksesin ose përhapjen e të dhënave personale nga persona të paautorizuar si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në

kundërshtim këto me parashikimet e nenit 27, 28 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të parashikojë rregulla/politika lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-surveimit CCTV të Qendrës dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesit i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar, si dhe të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk disponon Rregullore “Për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”), me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Qendrës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, gjatë proceseve përpunuese të Qendrës, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve të Qendrës, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale dhe sensitive që përpunon, kërkohen masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe sensitive.

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve të Qendrës, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli

i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit e Qendrës “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 28 i Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që, të gjithë punonjësit e Qendrës, të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 23.07.2024, paraqiti pretendimet mbi konstatimet e procesverbalit duke bashkëlidhur dhe provat si:

1. Rregullore “*Për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”;
  2. Deklaratë Konfidencialiteti;
  3. *Screenshot* të email-eve lidhur me trajnimet e personelit;
  4. Manual zbatimi i standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar;
  5. Tabela e informimit për sistemin e video-survejimit CCTV;
  6. Rregullore “*Për monitorimin, regjstrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në qendrën e zhvillimit, Bashkia Lushnje*”.
- Lidhur me Rregullore “*Për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, Zyra e Komisionerit konstaton se ky akt është sipas modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare dhe lidhur me veprimtarinë e Qendrës nuk parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (*për çdo kategori subjekti të dhënash*), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj. Kjo Rregullore

duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

- Sa i përket provave për trajnimin e stafit, Zyra e Komisionerit konstaton se këto trajnime nuk lidhen me mbrojtjen e të dhënave, por me ushtrimin e profesionit të secilit punonjës lidhur me trajtimin e rasteve të fëmijëve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

*b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*

*d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

*dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, germa “a”, “b”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

## V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi, të marrë masa për të përcaktuar afatet kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit të Qendrës, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 6- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj. lidhur me veprimtarinë që ushtron Qendra;
- 7- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të Qendrës;
- 8- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
  - i. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 4 dhe 5 më sipër;
  - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër;
  - iii. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

- 1- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 2- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;

- 3-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 26 . 07 .2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**